



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 43, Datë 29.03.2024

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË OSSH SH.A., PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË “RREGULLOREN PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES”, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 166, DATË 10.10.2016, TË BORDIT TË ERE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 7 pika 1, 16 pika 3 dhe 27 pika 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 26, 19 gërma “f” dhe 5 pika 23, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe nenit 6.2 të Rregulloren për Lidhjet e Reja në Sistemin e Shpërndarjes i ndryshuar, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 197/5 prot., datë 27.03.2024 të përgatitur nga Drejtoritë Teknike, “Mbi shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a. për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 646/1 prot., datë 30.01.2024, protokolluar në ERE me nr. 197/1 prot., datë 30.01.2024, shoqëria OSSH sh.a., paraqiti kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 166, datë 10.10.2016, të ndryshuar me vendimin nr. 177, datë 08.11.2016, vendimin nr. 234, datë 20.12.2019 dhe vendimin nr. 133, datë 06.06.2022, të bordit të ERE-s.
- Shoqëria OSSH sh.a. propozon këto ndryshime, duke synuar të sjellin lehtësime të procedurave të shoqërisë për të garantuar përputhjen me standardet rregullatore, për të adaptuar e njehësuar në mënyrë më të thjeshtë praktikrat rregullatore por në të njëjtën kohë për të vlerësuar maksimalisht ofrimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve në një kohë sa më të shkurtër.
- Kjo rregullore adreson marrëdhëniet ndërmjet OSSH sh.a. dhe Përdoruesve të Sistemit të Shpërndarjes, të cilët kërkojnë të realizojnë një lidhje të re ose të modifikojnë lidhjet e tyre ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, të përcaktojnë procedurat, afatet dhe tarifat për kryerjen e këtij shërbimi nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si dhe të realizojë një unifikim të cilësisë së punimeve, standardeve dhe karakteristikave teknike të lidhjeve të reja në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Bazuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neni 27, pika 3 parashikon se: *ERE miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licencuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe efçente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.*
- Duke vlerësuar se qëllimi i OSSH sh.a., në përcjelljen e këtyre propozimeve për ndryshime në rregulloren e lidhjeve të reja, lidhet me rritjen e efikasitetit në ofrimin e këtij shërbimi nga operatori i rrjetit, uljen e kostove dhe rritjen e transparencës ndaj konsumatorëve, vlerësojmë që në parim të nisë procedura për shqyrtim dhe konsultimin e këtyre propozimeve.
- Me qëllim garantimin edhe nga ana e ERE të sa më sipër, e shohim të nevojshme që së bashku me propozimin për fillimin e procedurës për shqyrtimin e këtyre propozimeve, të vendoset edhe detyrimi për OSSH sh.a., që të përcjellë në ERE brenda një afati 30 ditor, sqarimet e nevojshme në lidhje me propozimet që lidhen me ndryshimet e parashikuara në pikat 1.3 “Përkufizime”; Paragrafit 1.5; Paragrafi 1.12 Pjesa II, "Paragrafi 2.1; pika 5 "dhe Pika 3.5.3.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OSSH sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në “Rregulloren për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, miratuar me vendimin nr. 166, datë 10.10.2016, të bordit të ERE, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

- 1.1. Kudo në rregullore dhe anekse ku është përdorur termi “OSHEE” sh.a., do të ndryshohet me “OSSH” sh.a.

Paragrafi 1.3 “Përkufizime”

- 1.2. Të hiqet përkufizimi "Tarifa për Aplikim (pagesa) është pagesa që kryhet nga aplikanti në kohën kur aplikohet për lidhje, e në vijim ...”.

Përkufizimi: "Tarifa për Mbikqyrje dhe Tarifa për Kolaudim janë tarifa për kontrollin dhe vlerësimin e projektit teknik, mbikqyrjen e ndërtimit, testimit dhe kolaudimit të lidhjes, të cilat paguhen nga aplikanti".

ndryshon dhe bëhet

- 1.3. "Tarifa e verifikimit dhe kolaudimit fillestar të matësit janë tarifa për azhurnimin e rrjetit, shpenzime administrative dhe kolaudim fillestar i matësive të energjisë elektrike".

1.4. Të shtohet përkufizimi:

"Lidhje e Përkohëshme" është lidhje e energjisë elektrike e cila hapet vetëm për subjekte sezonale për periudha të caktuara sipas kërkesës së aplikantit.

1.5 Paragrafi 1.5 “Personat që kanë të drejtë të aplikojnë”.

Gërma “c” "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të miratojë kërkesën për lidhje të re, nëse përdoruesi apo aplikanti nuk ka plotësuar të gjitha kushtet teknike dhe standardet si detyrim për zbatimin e kodeve dhe rregullave në fuqi, ose kur rezultoni debitor dhe nuk ka shlyer detyrimet e mëparshme ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes"

Shtohet paragrafi

"... ndaj Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit. Në rast se në një objekt ka një kontratë ekzistuese nuk mund të aplikohet për lidhje të re por vetëm për modifikim të lidhjes ekzistuese (në rastet kur kemi vetëm një dokument pronësie).

1.6 Paragrafi 1.6 "Kërkesa për Lidhje të re".

Shtohet gërma “dh” Vetëprodhuesit

1.7 Paragrafi 1.11 "Përgjegjësia e instalimeve të brendshme elektrike të objektit të aplikuesit" në gërmat “b”, “c” dhe “e” **do të shtojmë fjalinë** “me anë të vetëdeklarimit, apo dokumentacion tjetër”.

1.8 Paragrafi 1.12 "Mënyra e komunikimit" do të shtohet fjalia "Aplikimi mund të bëhet edhe Online nëpërmjet aplikacionit në faqen zyrtare të shoqërisë" do të shtojmë edhe nëpërmjet aplikimit online.

Kjo për arsye të dixhitalizimit, transparencës së procesit si dhe lehtësi për aplikantët.

1.9 Pjesa II, "Dokumentacioni i kërkuar për aplikimin e një lidhje të re", Paragrafi 2.1 "Fuqia e instaluar 0-20 kW.

të hiqen pikat **4** "Fotokopje e certifikatës së rregjistrimit" **5** "Genplani i vendndodhjes së objektit" dhe **6** "Deklaratë instalimi dhe protokoll tokëzimi" dhe do të zëvendësohen me "**Vetëdeklarim nga aplikanti**", (bashkëlidhur kësaj shkresë formati).

1.10 Pika 4 të hiqet edhe në paragrafin 2.2 "Fuqia e instaluar 20-50 kW" dhe 2.3 "Fuqia e instaluar 50 - 100 kW" dhe "Për lidhje të reja në TM".

1.11 Certifikata e rregjistrimit të hiqet nga aplikimet për të gjitha fuqitë.

1.12 Paragrafi "Për lidhje të reja në TM", do numërtohet 2.4.

Në këtë paragraf **pika 5** "Projekti elektrik i objektit, i miratuar nga organet kompetente sipas legjisllacionit në fuqi" **shtohet:** "... edhe projekti elektrik i kabinës dhe linjës".

1.13 Pjesa III, "Procedurat e aplikimit për një lidhje të re", Paragrafi 3.1.1 "Procedurat dhe afatet kohore për lidhje të re, ose për modifikim të një lidhje ekzistuese në tension të ulët për fuqi të instaluar 0- 20 kw", gërma a, të bashkohen pikat i dhe ii në vërtetim dhe ndryshon "jo më shumë se 20 ditë pune"

1.14 Pika “c” “Llogarit kostot për lidhjen e re” shtohet "Pagesa e preventivit duhet të shlyhet nga aplikanti brenda 7 ditëve pune nga marrja e njoftimit. Në rast të kundërt aplikimi refuzohet dhe duhet të riaplikohet.

1.15 Paragrafi **3.5** "Dokumentacioni që kërkohet për lidhjen e burimeve gjeneruese", **ndryshon dhe ndahet në**

• **Pika 3.5.1 "Burimet gjeneruese hidro"**

1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit).

2. Fotokopje e vërtetimit të indentitetit (Kartë indentiteti).

3. Gen-Plan i vendosjes së objektit.

4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.

5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
 6. Projektin e plotë të nyjes se si do lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
 7. Kopje të licences së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
 8. Kontrata energjisë elektrike për nevojat vetjake.
 9. Kontrata e koncesionit(ose miratim nga Ministria)për ndërtimin e burimit gjenerues.
 10. Fuqia maksimale e gjeneruar aktive dhe reaktive.
 11. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
 12. Tipi i gjeneratorit sinkron dhe parametrat e tij.
 13. Parametrat kryesore të transformatorit të fuqisë.
- **Pika 3.5.2 “Burimet gjeneruese Fotovoltaike”**
 1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit).
 2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (Kartë identiteti).
 3. Gen-Plan i vendosjes së objektit.
 4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
 5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
 6. Projektin e plotë të nyjes se si do lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
 7. Kopje të licences së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
 8. Kontrata e energjisë elektrike për nevojat vetjake.
 9. Kontrata e koncesionit(ose miratim nga Ministria) për ndërtimin e burimit gjenerues.
 10. Fuqia maksimale e gjeneruar.
 11. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
 12. Parametrat kryesore të transformatorit të fuqisë.
 13. Manualet dhe skedat teknike te produkteve të sistemit PV, sic janë: panelet, inverterat, kabllot etj;
 - **Pika 3.5.3"Burimet gjeneruese eolike”**
 1. Kërkesë për lidhje në rrjetin shpërndarës (Formulari i Aplikimit).
 2. Fotokopje e vërtetimit të identitetit (Kartë identiteti).
 3. Gen-Plan i vendosjes së objektit.
 4. Hartë që të tregojë vendndodhjen e objektit në terren në një shkallë të përshtatshme.
 5. Profilin gjatësor të linjës elektrike dhe të gjitha detajet e tjera teknike që lidhen me të.
 6. Projektin e plotë të nyjes se si do lidhet objekti i ri në rrjetin e shpërndarjes.
 7. Kopje të Licences së inxhinierit elektrik që ka kryer projektimin.
 8. Kontrata e energjisë elektrike e nevojave vetjake.
 9. Kontrata e koncesionit (ose miratim nga Ministria) për ndërtimin e burimit gjenerues.
 10. Fuqia maksimale e gjeneruar.
 11. Skema principiale e brendshme e burimit gjenerues me të gjitha detajet teknike.
 12. Parametrat kryesore të transformatorit të fuqisë.

1.16 Shtohet pika 3.5.4 "Vetëprodhuesit" me dokumentacionin përkatës të listuar si më poshtë me tre nënkategori të ndara sipas fuqisë, konkretisht:

• **0-10kWp**

1. Kërkesa.
2. Deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga audituesi i certifikuar së bashku me certifikatën përkatëse dhe propozimin për fuqinë e instaluar.
3. Propozimin mbi modelin e matësit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike të tij sipas standardeve të OSSH.
4. Relacioni teknik.
5. Kopje origjinale të akt- kolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat.10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-IOA), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV.
6. Manuallet dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, sic janë; panelet, inverterat, kabllot, etj.
7. Licenca e inxhinierit projektues, i cili duhet të ketë pikën IOC në licensë për projektim dhe NPIO për zbatim.
8. Kartë identiteti.
9. Numri kontratës ekzistuese të abonentit (pa debi) me fuqi të njejtë me fuqinë e impiantit vetëprodhues.
10. Dokument pronësie të objektit ku do ndërtohet impianti fotovoltaik.

• **11-50kWp**

1. Kërkesa
2. Deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga audituesi i certifikuar së bashku me certifikatën përkatëse dhe propozimin për fuqinë e instaluar.
3. Projektin e miratuar nga persona fizike dhe juridike të licencuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes të miratuar nga ERE.
4. Propozimin mbi modelin e matësit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike të tij sipas standardeve të OSSH.
5. Relacioni teknik.
6. Kopje origjinale të akt kolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiant të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-IOA), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV.
7. Manuallet dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, sic jana: panelet, inverterat, kabllot, etj.
8. Të dhëna mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matësit të prodhimit të vendosur pas tij.
9. Licenca e inxhinierit projektues, i cili duhet të ketë pikën 1DC në licensë për projektim dhe NPIO për zbatim.
10. Kartë identiteti.
11. Numri kontratës ekzistuese të abonentit (pa debi) me fuqi të njejtë me fuqinë e impiantit vetëprodhues.

12. Dokument pronësie të objektit ku do ndërtohet impianti fotovoltaik.

• **51-500kWp**

1. Kërkesa.
2. Deklaratën e konsumit mesatar të tij përgjatë një viti sipas historikut të dy viteve të fundit ose në rast të mungesës të një historiku, raportin e auditit energjetik të lëshuar nga auditori i certifikuar së bashku me certifikatën përkatëse dhe propozimin për fuqinë e instaluar.
3. Projektin e miratuar nga persona fizike dhe juridike të licencuar për lidhjen e impiantit PV me rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me Kodin e Shpërndarjes të miratuar nga ERE.
4. Propozimin mbi modelin e matësit me dy drejtime skema e matjes neto dhe karakteristikat teknike të tij sipas standardeve të OSSH.
5. Relacioni teknik.
6. Kopje origjinale të akt kolaudimit të sistemit, firmosur nga projektues të licencuar për impiante të prodhimit të energjisë elektrike të rinovueshme nga dielli (kat. 10c) dhe zbatues të licencuar për ndërtimin e impianteve të prodhimit të energjisë (kat. NP-IOA), së bashku me konfirmimin e vetëprodhuesit të sistemit PV.
7. Manualët dhe skedat teknike të produkteve të sistemit PV, sic janë: panelet, inverterat, kabllo, etj.
8. Të dhëna mbi inverterin kryesor dhe karakteristikat e matësit të prodhimit të vendosur pas tij.
9. Licenca e inxhinierit projektues, i cili duhet të ketë pikën IOC në licensë për projektim dhe NPIO për zbatim.
10. Leje nga bashkia për "Punime që kryhen me deklaratë paraprake punimesh" VKM 408, dt 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" e ndryshuar.
11. Kartë identiteti.
12. Numri kontrates ekzistuese të abonentit(pa debi).
13. Dokument pronësie të objektit ku do ndërtohet impianti fotovoltaik.

1.17 Pjesa IV, "Tarifat për lidhje të reja", Paragrafi 4,2, pika 2" Punimet/shërbimet që do të paguhën nga aplikanti".

do të hiqet paragrafi

Koston e pjesës së kabllit më shumë se 50 ml (metër linear), vlera e të cilit do të përcaktohet referuar çmimit mesatar të këtij kabelli në librat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (klientet e pajisur me matës energjie në boks individual).

1.18 Paragrafi "Hapja e kanaleve të kabllave për realizimin e nyjeve bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me rrjetin ekzistues (terminale, muftë, etj), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë dhe sistemet rrugore".

ndryshon dhe bëhet

"Pjesa e kabllit më shumë se 50 ml, hapja e kanaleve të kabllave për realizimin e nyjeve bashkuese me rrjetin ekzistues shpërndarës, materialet elektrike që realizojnë lidhjen me

rrjetin ekzistues (terminale, muftë, etj), si dhe rehabilitimin (e përkohshëm dhe të përhershëm) të terrenit, duke përfshirë dhe sistemet rrugore.

- 1.19 Shoqëria OSSH sh.a., përveç propozimeve ka bashkëlidhur edhe formularin e vetëdeklarimit për aplikuesit familjare dhe jofamiljare, të cilët do të jenë pjesë e anekseve të rregullores të sipërcituar.
2. OSSH sh.a. të përcjellë në ERE, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, sqarimet e nevojshme për të argumentuar shkakun ligjor për propozimin e secilit ndryshim apo shtesë.
3. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standarteve, të njoftojë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI